



## Përmirësimi i menaxhimit financiar në njësitë partnere të Intercooperation

### Konteksti i projektit

Një sistem në të cilin funksionet vendore ishin të paqarta dhe financimi sigurohej nëpërmjet granteve të kushtezuara shumë të kontrolluara, tashmë është një sistem në të cilin funksionet janë relativisht të qarta dhe qeverisjet vendore kanë më shumë autonomi. Për të parë dhe qartësuar informacionin e tyre financiar, rezultatet financiare, IKU punoi për një paraqitje të thjeshtë dhe domethënëse të të dhënave (informacioni i njësive ishte i shpërndarë, i pakudruar dhe grupuar, nuk lexohej performanca dhe treguesit financiarë nuk i dispononin në mënyrë të njëjtë të gjithë departamentet, etj).

### Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit ishte sigurimi i asistencës për një menaxhim të mirë të financave publike sipas kërkesave të ligjit për hartimin e programit buxhetor afatmesëm. Produkti më i rëndësishëm është ndërtimi i një modeli (database) që i shërben analizës financiare.

### Aktivitetet kryesore

1. Aftësimin e njësive vendore në caktimin sa më realist të prioriteteve.
2. Aftësimin e këtyre njësive në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.
3. Ofrimin e metodave lehtësuese për këto njësi vendore në mbledhjen e informacionit dhe analizimit të këtij informacioni.
4. Identifikimin e të gjitha potencialeve natyrore e humane mbi të cilat mund e duhet të mbeshtetet zhvillimi i njësive vendore.
5. Ngritjen e një rrjeti bashkepunimi mes njësive vendore dhe aktorëve të përfshirë në proceset zhvilluese.
6. Aftësimin e njësive vendore në rritjen e kapaciteteve financiare dhe menaxhimit sa më efikas të këtyre kapaciteteve.
7. Hartimi dhe përdorimi i një database që ruan të dhënat financiare dhe lejon parashikimin ndryshimit të tyre në afate 1-3 vjeçare.



### Rezultatet e arritura

- U realizuan dy dokumenta të plote buxheti të hartuar nga Komuna Velipoje dhe Dajç, në bashkepunim me IKU-n të cilët janë të thjeshtë e të kuptueshem. Dokumenti përmban:
  - Analize të të ardhurave dhe shpenzimeve të tre viteve të mëparshme;
  - Paraqitje në mënyrë të thjeshtë dhe e shoqëruar me grafike të trendave në vite, strukturës të të ardhurave, problemeve në mosrealizimin e buxhetit;
  - Përqendrimi për parashikimin e buxhetit 2009, vetëm tek pjesa e fondeve diskrecion i njësive vendore, duke marrë parasysh ruajtjen apo rritjen e nivelit të shërbimeve të vitin e kaluar, inflacionin, ndryshimet ligjore, etj.;
  - Përgatitja e projektit të buxhetit 2009 për në këshill (udhëzimet dhe shifrat e buxhetit 2009 erdhën nga Ministria në muajin dhjetor dhe draftet pësuan ndryshime, duke bërë të mundur miratimin e tyre në fund të dhjetorit ose fillim të janarit- jo në muajin nëntor sipas ligjit)
- Me Bashkinë Shkoder u hartua një draft i shkurtuar i buxhetit 2009, rreth 25 faqe. (materiali i përgatitur nga stafi ishte rreth 160 faqe, shumë i lodhshëm dhe jo me objektiva të qarta për përdoruesit e informacionit). Kjo mënyrë e shkurtuar e buxhetit lehtësoi dhe diskutimin e draftit me komisionin ekonomik të këshillit. Në këshill buxheti u shoqërua dhe me një prezantim të mesazhit të kryetarit me power

point. Mbledhja u organizua e hapur. Materiali u vlerësua nga Këshilltarët dhe kaloi pa problem

- Po me Bashkinë Shkoder, mbas miratimit të buxhetit 2009 në këshill, u përgatit materiali për një format gazete bashkiake për publikimin e buxhetit. Gazeta përmbante objektivat më të rëndësishme të buxhetit 2009, politikat fiskale e lehtësitë për disa grupe, si dhe investimet më të rëndësishme që do të sjellin ndryshime në infrastrukturë.

### FAKTET KRYESORE

#### PARTNERET:

- ✓ Swiss Cooperation/Inter cooperation, projekti i DLDP

#### KOHËZGJATIA:

2008 - 2009

#### PËRFITUESIT:

- ✓ Njësitë e Pushtetit Qendrorë dhe Lokal

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [uri@uri.org.al](mailto:uri@uri.org.al)  
Web: [www.uri.org.al](http://www.uri.org.al)

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.